
6XX BLOKU I ANALIZËS SË PËRMBAJTJES

LISTA E FUSHAVE

- 600 Emër vetjak si emërtim lëndor
- 601 Emër organizate si emërtim lëndor
- 602 Emër familje si emërtim lëndor
- 604 Emër dhe titull si emërtim lëndor
- 605 Titull si emërtim lëndor
- 606 Emër lënde si emërtim lëndor
- 607 Emër gjeografik si emërtim lëndor
- 608 Emërtimi lëndor kronologjik*
- 609 Forma si emërtim lëndor*
- 610 Emërtime lëndore të pakontrolluara
- 620 Kërkimi me vend të botimit
- 627 Fjalët kyçe - NUK
- 675 Klasifikimi Dhjetor Universal (KDU)
- 676 Klasifikimi Dhjetor i Djujt
- 680 Klasifikimi i Bibliotekës së Kongresit
- 686 Klasifikime të tjera

Në sistemin e përbashkët të katalogimit emërtimet lëndore vendosen në formë të strukturuar në fushat 600–609 dhe sipas parimeve të sistemit të përzgjedhur për emërtimet lëndore (p.sh. lista e emërtimeve lëndore ose thesarët). Për klasifikim lëndor të unifikuar në katalogimin e përbashkët përdoret Lista e përgjithshme e emërtimeve lëndore COBISS (SGC), e cila është në dispozicion si bazë e njësuar, ndërsa në regjistrime mund të shtohen edhe emërtimet lëndore nga sistemet e tjera. Rregullat për klasifikimin lëndor përmes Listës së përgjithshme të emërtimeve lëndore COBISS (SGC) janë të përshkruara në udhëzimet *Përcaktimi lëndor përmes SGC-së*, të cilat janë të disponueshme na faqen elektronike SGC <https://www.cobiss.si/sgc/>. Nëse shtoni emërtime lëndore edhe nga sistemet e tjera, si udhëzime të përgjithshme apo kritere bazë për zgjedhjen e termave dhe formimin e rubrikave lëndore respektohen udhëzimet në *Splošni slovenski geslovník: navodila za predmetno označevanje knjižničnega gradiva in geslovník*. Ljubljana: Narodna in univerzitetna knjižnica, 2002, ose udhëzimet e sistemeve të tjera të vlefshme për klasifikim lëndor. P.sh. për klasifikim më të hollësishëm në fushën e mjeksisë përdoren termat nga MeSH (Medical Subject Headings).

Me krijimin e bazës së njësuar të të dhënave SGC dhe aplikimit të kontrollit të njësuar të emërtimeve lëndore në sistemin e katalogimit të përbashkët, ka ndryshuar mënyra e shënimit të të dhënave në fushat 60X. Emërtimet lëndore nga SGC nuk shënohen në mënyrë manuale, mirëpo ato transferohen nga baza e njësuar e të dhënave. Lidhja midis regjistrimeve të njësuar dhe emërtimeve lëndore në fushat 60X bëhet përmes nënfushës 60X3 – *Numri i regjistrimit të njësuar*.

Kur emërtimet lëndore janë të lidhura me SGC, format e papranuara nuk shënohen në regjistrimet bibliografike, ndërsa format për emërtimet e tjera lëndore vendosen në fushat 960–969. Kërkimi bëhet njëkohësisht në fushat 600–609 dhe 960–969. Fushat 960–969 lidhen me fushat 600–609 përmes nënfushës 6, në të cilën, tek të dy fushat në lidhshmëri shënohet një numër dyshifror (01-99).

Te plotësimi i fushave 600–609 dhe 960–969 përdoret nënfusha 2, në të cilën shënohet kodi i sistemit të emërtimeve lëndore, i cili përzgjidhet nga lista e kodeve. Nëse përdorni sistemin lokal të emërtimeve lëndore në gjuhën vendase, kodi i së cilës nuk ndodhet në listën e kodeve, kjo nënfushë nuk plotësohet, në të kundërtën plotësimi në nënfushës 2 është i detyrueshëm.

Lista e mëposhtme me kodet e sistemeve të emërtimeve lëndore nuk është e plotë, por ajo ndryshon dhe përditësohet sipas nevojës:

CAE	<i>Emërtime lëndore të Bibliotekës Kombëtare të Kanadasë (Version në anglisht)</i>
CAF	<i>Emërtime lëndore të Bibliotekës Kombëtare të Kanadasë (Version në frëngjisht)</i>
EET	<i>Thesar arsimor evropian</i>
EET/slv	<i>Thesar arsimor evropian/Përkthim në sllovenisht</i>
EUROVOCE	<i>Thesar EUROVOC (Version në anglisht)</i>
EUROVOCS	<i>Thesar EUROVOC (Version në sllovenisht)</i>
GZL	<i>Emërtime lëndore për letërsi</i>
INIS	<i>Sistemi i informacionit bërthamor ndërkombëtar: Thesar</i>
INIS/slv	<i>Sistemi i informacionit bërthamor ndërkombëtar: Thesar/Përkthim në sllovenisht</i>
LC	<i>Emërtime lëndore të Bibliotekës së Kongresit</i> Lista e emërtimeve lëndore është e publikuar në adresën: https://id.loc.gov/authorities/subjects.html
LCCH	<i>Emërtime lëndore për fëmijë të Bibliotekës së Kongresit</i>
MECH	<i>MECH - Inxhinieria mekanike</i> Lista e emërtimeve lëndore është e publikuar në adresën: https://meshb.nlm.nih.gov
MESH	<i>Emërtime lëndore mjekësore</i>
MESH/slv	<i>Emërtime lëndore mjekësore/Përkthim në sllovenisht</i>
NAL	<i>Emërtime lëndore të Bibliotekës Bujqësore Kombëtare Sh. B.</i>
NUK	<i>geslovník NUK-a (Listë e terma lëndorë NUK)</i> Fjalori ndodhet në faqen elektronike: https://sssg.nuk.uni-lj.si
PKK	<i>Predmetnik za katoliške knjižnice (Lista lëndore për Bibliotekat katolike)</i>
RPLB	<i>R"kovodstvo za predmetizacija na literaturata v bibliotekite</i>
SGC	<i>Lista e përgjithshme e emërtimeve lëndore COBISS.SI</i> Lista e emërtimeve lëndore është e publikuar në adresën: https://plus.cobiss.net/cobiss/si/sl/sgc
TPIT	<i>Thesar i termave indeks për psikologjinë</i>
TPIT/slv	<i>Thesar i termave indeks për psikologjinë/Përkthim në sllovenisht</i>
eng	<i>lista lëndore lokale në anglisht</i>

Nënfusha 2 përdoret edhe në fushën 686, ku shënohen kodet nga lista e kodeve për sistemet e klasifikimit. Udhëzime më të hollësishme jepen në fushën 686.